

NJOFTIM
Nr. 429, datë 3.4.2019

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË FINANCIVE DHE
EKONOMISË**

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-Ndërmarrja e Riparim Shërbimeve	Bulqizë	443 671	415 312	28 359	23	23	16.4.2019	11:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo Garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo Garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës

fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo Garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në

llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al

